



PLANI OPERACIONAL PËR VITIN 2021

**PËR ADMINISTRIMIN E QËNDRUESHËM TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR.**



MIRATOHET

ZV/ KRYETARI I BASHKISË

Arben GJURAJ

1.HYRJJE

Rëndësia e pyjeve është e gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i bërë një element thelbësor të jetës sonë. Përfitimet dhe impakti i pyjeve, sipas përdorimit të tyre, mund të kategorizohet në:

Pyje për Njerëz: Mekanizëm shkëmbimi ndërmjet O₂ që ato lëshojnë dhe absorbimit të CO₂. Një pemë gjethore e rritur çliron në ditë oksigjen për 2-10 persona. Janë një barrierë e ndotjes nga zhurmat, duke reduktuar deri në 50% të asaj që dëgjohet nga humanët. Janë një burim i përkryer i qetësisë dhe pasurimit të vlerave shpirtërore përmes vlerave të tyre të pamatshme.

Pyje për Zhvillim: Sigurojnë lëndën drusore për ndërtim, dru zjarri dhe rrëshirën, si bazë për një sërë industrish. Zonat pyjore përbëjnë një element thelbësor për zhvillimin e turizmit, si zonat bregdetare, malore apo ato urbane. Krijojnë mundësi për punësim, si përmes operacioneve në pyll, ashtu edhe përmes grumbullimit të bimëve jodrusore. Në vendet në zhvillim, vlerësohet se pyjet angazhojnë 80% të popullsisë së këtyre vendeve me produktet jodrusore nga pyjet.

Pyje për Ushqim: Janë burim për produkte, si bimë mjekësore, fruta pylli apo edhe gjuetia e kontrolluar. Veçanërisht marrin një vlerë të jashtëzakonshme përsa i përket bimëve mjekësore. Pyjet janë një burim i mirë për ujërat nëntokësorë, duke siguruar filtrimin e reshjeve në nëntokë dhe mundësi më të mira për ujë të pijshëm dhe vaditje. Shërbejnë për të krijuar breza pyjorë të domosdoshëm për bujqësinë, veçanërisht për kulturat e ndjeshme ndaj erërave. Nga ana tjetër reduktimi i shpejtësisë së erës, krijon mundësi më të mira për pjalmim nga bletët.

Pyje për Natyrën: Pyjet kanë efekte mbi temperaturën si në nivel global, ashtu edhe lokal, pasi ndikojnë në freskinë e mjediseve, duke ulur njëkohësisht nevojën për energji. Përbëjnë shtratin e duhur për biodiversitetin, duke filluar nga insektet e deri tek bletët e zogjtë që përhapin polenin e farërat. Pothuajse gjysma e të gjithë specieve në nivel global e zhvillojnë jetën e tyre në pyje. Janë një parandalues dhe luftues i mirë i përmytjeve. Sistemet rrënjore mbajnë tokën të lidhur në rastet e reshjeve të rënda, veçanërisht e nevojshme përgjatë shtretërve të lumenjve.

Qëllimi ynë fundor është mirëqenia, siguria, paqe dhe harmoni e qytetarëve të saj, ndaj dhe qëllimi që duam të arrijmë nga “Pyjet që duam” është *“kontribut i qëndrueshëm për një jetë më të mirë për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes”*. Mjedisi në përgjithësi dhe pyjet në veçanti, janë skena ku zhvillohet jeta njerëzore, aktiviteti ekonomik dhe ushtrohet qeverisja, ndaj cilësia dhe gjendja e pyjeve kanë një ndikim thelbësor në disa dimensione, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në cilësinë e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit, në zhvillimin e



bujqësisë, energjisë e turizmit, në uljen e varfërisë, zhvendosjet e popullsisë, zbutjen e konflikteve sociale, në mbrojtjen nga përmytjet, sigurinë e vendit.¹

II. PLANI OPERACIONAL

Qëllimi i hartimit të Planit Operacional , mbështetet në Qëllimin e Politikës Kombëtare:

Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullësor brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër.

Plani Operacional hartohet bazuar në Objektivin kryesor të Politikës së Bashkisë Shkodër, për një administrim të qëndrueshëm të Pyjeve dhe Kullotave Bashkiake duke përfshirë komunitetin e zonave pyjore, perdoruesit e Pyjeve e Kullotave të Bashkisë Shkodër.

Ky Plan Operacional është një Plan Veprimi i cili ka një afat veprues 1 vit. Për cdo vit pasardhës ai i nënshtrohet përditësimit me problemet e dala gjatë rrjedhës së procesit kompleks të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve/kullotave Bashkiake.

Rezultatet e pritëshme që do arrihen gjatë vitit 2021, do të specifikohen në këtë plan.

- 1. Administrimi dhe Zhvillimi i Qendrueshëm i Pyjeve Kullotave dhe burimeve të tjera natyrore me origjinë Pyjore e Kullësore.***
- 2. Krijimi i mundësive për gjenerim të ardhurash për komunitetin në përgjithësi dhe për vetë banorët e zonave pyjore në veçanti.***
- 3. Gjetja e mekanizmave për një mbrojtje më të mirë të fondit Pyjore dhe Kullësor nga prerjet ilegale dhe zëniet e përdorimit të kundraligjeshëm të fondit Pyjor dhe Kullësor.***

Plani Operacional ka si prioriteti bazë përdorimin e metodave ligjore për gjetjen e mundësive për gjenerim të ardhurash për komunitetin e zonave pyjore në Bashkinë Shkodër.

Trajtimi i pyllit, shfrytëzimi me prioritet i kullotave natyrore me shtresë barishtore dhe mbulesë drunore, grumbullimit të bimeve medicinale etj, do të bëhet duke marrë në konsideratë tradicionalitetin e përdorur nga zona, e në integrim të plotë me rekomandimet e planeve të mbarshtrimit (menaxhimit) atje ku këto plane ekzistojnë dhe me Projekte Teknike atje ku këto Plane nuk ekzistojnë.

Ne funksion të një Menaxhimi dhe Administrimi më të mirë të pyjeve dhe kullotave, përdorimi me efikasitet i burimeve njerëzore, stafit teknik dhe jo vetëm.

¹ Politika e Qeverise mbi Pyjet



III .IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE TË BASHKISË, BAZË PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.

3.1 Qëllimi kryesor është që:

Administrimi, Menaxhimi dhe trajtimi i pyjeve dhe kullotave do të bëhet në menyrë të qëndrueshme me synim: **rritjen e produktivitetit dhe të funksioneve të tjera të Pyjeve dhe Kullotave**. Për këte janë identifikuar problemet kryesore që lidhen me situatën aktuale të tyre.

3.2. Analiza e situatës aktuale në Pyje dhe Kullota të kaluara në pronësi të Bashkisë Shkodër.

Mbi bazën e identifikimit të problemeve për situatën aktuale, do të bëhet analiza e treguesve sasior dhe cilësorë, nëpërmjet të cileve identifikohen më mirë pikat e forta dhe të dobëta të kushteve, që aktualisht ndikojnë në menaxhimin dhe administrimin e Pyjeve dhe Kullotave dhe që domosdoshmerisht kërkojnë një vëmendje më të madhe për përmirësimin e tyre në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të Pyjeve dhe Kullotave.

Nga ky identifikim arrijmë në përfundimet:

3.2.1 Anët e forta

Eksperiencia tradicionale e trajtimit të pyjeve dhe kullotave Bashkiake, kanë bërë të mundur që problemet e Pyjeve të integrohen në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm të tyre. Në lidhje me këte ne mund të nënvizojmë:

- a. Sipërfaqja e konsiderueshme e mbuluar me pyje që kanë kapacitete të mira prodhuese, kanë mundësi të mëdha për gjetjen e mekanizmave për vënien e resurësive të tyre në shërbim të komunitetit.
- b. Identifikimi i përdoruesve të pyjeve (pretendimet), dhe i atyre tradicional, ekzistenca e kufijeve të sipërfaqeve Pyjore e Kullosore sipas përdoruesve (pretendimeve).
- c. Ekzistenca e disa planeve të Menaxhimit, apo Projekteve teknike, si bazë kryesore teoriko-praktike që orjenton një Administrim dhe Menaxhim të bazuar dhe të qëndrueshëm. Në këte focus lind mundësia për të percaktuar strategjinë e zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave për një periudhë të caktuar kohore.
- d. Organizimi i përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave në shoqata të PPKK, e cila krijon mundësi për rritje të kapaciteteve menaxhuese të pyjeve dhe të shkëmbimeve të eksperiencave në fushën e trajtimit të tyre.

3.2.2 Anet e dobëta

Në këte drejtim theksojmë:



- a) Niveli i ulët ekonomik i komunitetit të Bashkisë në zonat Pyjore, e cila ka ndikuar direkt në shfrytëzimin jo racional dhe në përshtashmeri të burimeve natyrore me origjinë Pyjore , në përputhje me kushtet dhe rregullat teknike e ligjore. Për pasojë janë hasur probleme të natyrave të ndryshme, të cilat kane ulur kapacitetin prodhues të pyjeve dhe kullotave Bashkiake.
- b) Infrastruktura pyjore është e dobët ose mungon teresisht. Kjo ndikon në uljen e kapaciteteve menaxhuese dhe administruse të Pyjeve dhe Kullotave në funksion të vjeljeve të resurseve .
- c) Mungesa e Planeve të Menaxhimit bëhet pengesë për shfrytëzimin racional te burimeve pyjore.
- d) Mungesa e hipotekimit të pyjeve dhe kullotave sipas ligjit mbi pronësinë. Kjo ka sjellë frenimin e gjetjeve të donatoreve për investime kapitale në funksion të zhvillimit dhe të rritjeve të kapaciteteve prodhuese të tyre.

e) **3.2.3 C'farë duhet të ndryshojmë për përmiresim situatës**

Pyjet dhe kullotat, duke qenë një pasuri Kombëtare dhe përdorime shume funksionale, në vijim të përmbushjes të këtyre funksioneve kerkohet një administrim dhe menaxhim shumë i kujdeshem, duke realizuar veprime mbrojtëse, administruese e menaxhuese, në përshtatshmëri me strategjinë kombëtare të zhvillimit të tyre, në përputhje me Strategjinë e zhvillimit te Bashkisë, rekomandimeve të projekteve të menaxhimit, të eksperiences tradicionale të trajtimit të pyjeve etj.

Kjo strategji, pavarisht nga forma e pronësisë, duhet ta konsiderohet të vlefshme në shërbim të rritjeve të kapaciteteve prodhuese të pyjeve dhe kullotave.

Pikerisht këtu qëndron dhe rëndësia e hartimit të këtijë plani operacional për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për vitin **2021**, i cili do të jetë në përshtatshmëri te këtyre kërkesave.

Në përmiresim të kësaj kërkesë strategjike, Sektori i Pyjeve për vitin 2021, parashikon:

- Rritjen e kapaciteteve Menaxhuese dhe Administruese të stafit të Pyjeve dhe kullotave të Bashkisë, që lidhen me teknikët, specialistët, shoqatat dhe të vete përdoruesve.
- Mbrojtjen, administrimin, menaxhimin dhe trajtimin e Pyjeve dhe kullotave në mënyre tradicionale duke e integruar me rekomandimet teknike që japin planet dhe projektet e menaxhimit të tyre.
- Nepërmjet trajtimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave duke tentuar për rritjen e kapaciteteve prodhuese, vjeljen e produkteve pyjore dhe jo pyjore (Burimet natyrore), në funksion të rritjes së nivelit ekonomik e social të komunitetit dhe të vetë Bashkisë.

3.2.4. Mekanizmat që do të përdoren.

- a. Për rritjen e kapaciteteve të teknikëve nepermjet trajnimit te tyre.
- b. Ndergjegjesim i banoreve të zonave pyjore, shoqatave te perdoruesve etj, mbi ndërhyrjet në fondin pyjor duke rritur kapacitetet menaxhuese, mbrojtëse dhe administruese të përdorueseve të pyjeve.



c. Nepërmjet përdorimit të trajtimit dhe shfrytëzimit të kapaciteve prodhuese, do të punohet me subjekte të specializura, shoqatat e përdoruesve të pyjeve për rritjen e të ardhurave ekonomike që do të lehtësojnë barrën financiare që duhet për këtë administrim dhe menaxhim të qëndrueshëm.

Drejtimit e punimeve do të jenë:

- Shfrytëzimi i pyjeve do të bëhet brenda mundësisë vjetore të vjeljes së lëndes drusore që na ofron pylli, duke përcaktuar objektet dhe teknikat e vjeljes në përshatshmëri me rekomandimet e projekteve dhe veçanarisht atij të mbarshtrimit.
- Për lëndën drusore dhe prodhimet e tjera pyjore që nevojiten për plotësim të nevojave, do të bëhet e përqendruar në bazë fshati sipas nevojave për familje sipas planeve të menaxhimit, në zbatim të ligjit e akteve n/ligjore dhe nën drejtimin e kontrollin e teknikëve dhe specialistëve të Bashkisë.
- Dhënia në përdorim e fondit pyjor kullosor për qëllime të përcaktuara në ligjin specific.

3.2.5.Cili është Fondi pyjore që i është kaluar në pronësi Bashkisë.

TABELA PERMBLEDHESE							
Siperfaqet pyjore/ kullosore sipas VKM nr 433/2016 i ndryshuar.							
Nr	Emertimi	sip pyje/ha	sip HA kullote	sip HA bujqesore	sip HA bujqesore troje	sip HA Inproduktve /shkembore	SIP TOT HA
1	Ek Maja e Pejës	0.0	4668.3	0.0	0.0	0.0	4668.3
2	Ek Rosek Rrjoll	0.0	1329.3	0.0	0.0	0.0	1329.3
3	Ek Shale	0.0	851.1	0.0	0.0	0.0	851.1
4	Ek Theth	0.0	95.2	0.0	0.0	0.0	95.2
5	Ep Brucaj	2853.6	140.1	0.0	0.0	192.9	3186.6
6	Ep Bushat Berdice	79.3	0.0	0.0	0.0	7.1	86.4
7	Ep Cukal	11.1	0.0	0.0	0.0	2.4	13.6
8	Ep Drin Gjader Kir	151.0	0.0	0.0	0.0	0.0	151.0
9	Ep Lugina e Kirit	7633.6	770.1	0.0	0.0	1552.4	9956.0
10	Ep Lugina e Shales 1	4344.4	194.2	11.4	7.8	666.5	5224.3
11	Ep Lugina e Shales 2	2722.5	184.0	0.0	0.0	977.1	3883.6
12	Ep Pruemos Sheldi	1980.8	1483.3	0.0	0.0	109.4	3573.5
13	Ep Rosek Drisht	6310.1	13.9	0.0	0.0	499.8	6823.8
14	Ep Shllak 1	1010.0	0.0	2.5	0.0	35.7	1048.2
15	Ep Shosh 2	2019.8	102.2	0.0	0.0	506.7	2628.7
16	Ep Shosh 1	3607.0	442.1	0.0	0.0	457.5	4506.6
17	Ep Shosh 2-2	40.8	0.0	0.0	0.0	23.9	64.7
18	Ep Tarabosh	33.2	532.7	0.0	0.0	0.0	565.9
	Total	32797.0	10806.5	13.9	7.8	5031.5	48656.7



Sipas Tabelës së mësipërme, sipërfaqja e kalimit në pronësi të pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë është bërë me VKM nr. 433, date 08.06.2016 I ndryshuar dhe është 48,656.7 ha .



4. AKTIVITETE KRYESORE

Të ardhurat e realizuara nga aktivitetet e Pyjeve për vitin 2020 janë në vlerën prej 1 485 890 leke.

Mundësia e realizimit të të ardhurave nga pyjet e kullotat është shumë më i madh, nisur nga potencialet që ofrojnë.

4.1. Burimet financiare për realizimin e planit operacional :

Për realizimin e planit operacional të administrimit dhe të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave kërkohen, përveç masave tekniko ligjore, edhe burime financiare për të mbështetur përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të parashikuar më sipër.

4.1.1.. Analiza e realizimeve financiare.

Për të pasur një administrim, menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, përveç kujdesit që duhet treguar për trajtimin në funksion të rritjeve të kapaciteteve prodhuese dhe të

plotesimit të funksioneve të tjera që ofron pylli dhe mjedisi pyjor në përgjithësi, duhet patjetër që këto kapacitete të gjenerojnë të ardhura.

Të ardhurat që grumbullohen nga produktet pyjore e kullosore do të shërbejnë, jo thjesht për rritje të kapaciteteve prodhuese të pyllit dhe kullotës, por edhe për rritjen ekonomike të komunitetit dhe me gjërë .

Më poshtë po specifikojmë disa nga komponentët më të rëndësishëm që mendojmë se gjenerojnë burime financiare (të ardhura).

A. Cilet janë këto Komponente ?

Nisur nga gjendja e Pyjeve dhe Kullotave, trajtimi i deritanishëm i tyre, përfshi përvojat, traditat, mundësitë dhe mjaft tregues të tjerë, ku specifikojmë se drejtimet më kryesore që japin të ardhura financiare janë:

- ✚ Shfrytëzimi i lëndës drusore me prerje shëndetësi etj. (Dru zjarri) për furnizimin e banorëve të zonave pyjore.
- ✚ Shfrytëzimi i Prodhimit e dyta pyjore .
- ✚ Dhënia e fondit Pyjore e Kullosor në përdorim.
- ✚ Shfrytëzimi i kapaciteteve të burimeve të Bimeve MET-së
- ✚ Shfrytëzimi i pyjeve natyrore (të destinura për kullotje).
- ✚ Shfrytëzimi racional i kullotave/tarifat.

Nevojat për prodhime pyjore, problemet dhe zgjidhja e tyre.

Komuniteti që banon në Zonat Pyjore e Kullosore, jetesën e ka të lidhur pikërisht me Pyjet dhe burimet që sigurohen prej tyre. Nevojat natyrisht që janë të medha, por edhe zgjidhjet në mënyrë të përqendrura janë mjaft të vështira për vetë kushtet që paraqet territori i Bashkisë, i veshur me Pyje dhe Kullota .

Nevojat potenciale fokusohen kryesisht në disa drejtime:

- Sigurimi lëndës djegëse për ngrohje .
- ✚ Dru zjarri në vit afersisht nevojiten, kjo edhe sipas INSTAT, rreth 125 000 mst
 - Prodhimet e tjera me origjinë pyjore e kullosore
- ✚ Fruta geshtenje për konsum dhe treg afersisht 0 kv/ kjo për shkak të sëmundjes që ka kapur këto masivë të gështenjës prej më shumë së 3 vitsh.
- ✚ Boçe Pische 205 kv
- ✚ Bimë medicinale të llojeve ndryshme për treg 1300 kv
- ✚ Rrënje shqope 200 kv

Për sa më sipër, mundësitë e realizimit të këtyre treguesve janë më të pakta, bazuar në planet e Menaxhimit dhe të mundësitë ofertuese për vjeljen e këtyre produkteve.



B. Vlersimi i tregut të produkteve kryesore me origjinë pyjore e kullosore

Nga Observimi i tregut rezulton se produktet më të kërkuara janë:

- ✚ Drutë e zjarrit që kërkohen nga popullata urbane për lëndë djegëse për ngrohje dhe gatim pa kufizim .
- ✚ Frutat e arroveve (gështenj, Lajthi dhe Arra), pa kufizim. Bimët medicinale (Sherebela, Trumza, Lizna, lule bliri, Sanza, Xhirokulli, Rigoni i kuq, kërpullat, boronica(qershigla) si dhe një serë bimesh të tjera, kërkohet pa kufizim, sidomos Sherebela.
- ✚ Boçet e pishës së butë në menyrë të kufizuar.
- ✚ Rrënjët e Shqopës e kufizuar.

Natyrisht që çmimet e shitjes me shumicë variojnë sipas kërkesës, llojshmërisë së produktit, kostos së prodhimit (nxjerrjes), përpunimit, vlerës së përdorimit, stinës së prodhimit etj. Por sipas eksperiencës dhe monitorimeve të tregut çmimet mesatare të produkteve të identifikura më sipër variojnë me ndryshime dhe luhet, kjo lidhet dhe me kursin e këmbimit valutorë në treg. Të gjitha këto në këtë plan operacional janë marrë në konsideratë.

C. Vlersimi i Kapaciteteve të Burimeve.

Duke ju referuar të dhënave që na afrojnë Projektet e menaxhimit, kapaciteti i llogaritur në vlerë për të ardhurat nga Fondi Pyjor Kullosor, pavarësisht nga mundësia e shfrytëzimit paraqitet si në **tabelat ndodhur në Aneksion e këtij Plani.**

Për llogaritjen e tyre janë marrë për bazë vetëm tarifat që janë të miratuara nga VKM-ve nr.391 datë 21.06.2006 i ndryshuar me VKM nr.1064 date 22,12.2010,VKM nr.632 date 11,06,2009 Vendime këto që përcaktojnë tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.

Gjithashtu janë mbështetur edhe në mundësit dhe hapsirat ligjore që përcakton Ligji 57/2020 për pyjet. Në ligjin 9693 date 19.03.2007 “Për Fondin kullosor, Ligjin nr. 10120 datë 23.04.2009 “Për Bimet medicinale” etj. Mbi bazën e këtyre dokumentave ligjore dhe teknike janë përcaktuar edhe kapacitetet që ofron pylli në vjeljen e materialit drusor dhe prodhime të dyta pyjore si dhe mundësitë tona për vjeljen dhe përdorimin e tyre.

Tabela nr 3 Bashkëlidhur për prodhimet e dyta e Bimët Medicinale, Miratuar me Shkresën e Ministrisë së Turizmit e Mjedisit nr 4047/1 prot dt 01.07.2020.

Tabela Nr.4 Per Kullotat. Miratuar me VKB nr 4 dt 30.01.2018



Tabela nr 5 . Investime te planifikuara ne Buxhetin e vitit 2020

Vjelja e potencialeve të mësipërme, nga ana jonë kërkon një angazhim më të madh dhe kryesisht puna jonë do të përqendrohet në ruajtjen e fondit pyjor/kullosor, si dhe me një angazhim dhe ngritje të strukturës menaxhuese të pyjeve, e gjithashtu realizimi i vjeljes së tarifave.

Deri tani kemi patur mangësi në vjeljen e tarifave si më poshte:

- ✚ Lënda djegëse, drutë e zjarrit, në përgjithësi janë siguruar në menyre individuale nga përmirësimet e pyjeve në prozmet e përdoruesve dhe me pak të përqendruar në ngastra e n/ngastra të veçanta të dhena për shfrytëzim.
- ✚ Në të njëjten mënyrë është siguruar bari dhe gjethi për blegtori (per konservim).
- ✚ Kullotja e pyjeve në natyrë nga blegtoria është bërë e pa kontrolluar.
- ✚ Shfrytëzimi i kullotave është bërë nga vetë fshatarët .
- ✚ Shfrytëzimi i BMTE-es. Në natyrë është bërë tërësisht individuale, dhe është drejtuar nga disa subjekte.
- ✚ Grumbullimi i frutave dhe farnave pyjore është bërë po në të njëjtën mënyrë si BMET.

D .Mangësitë e identifikuar në vjeljen e të ardhurave.

Nga analiza e realizimit të të ardhurave financiare gjatë vitit 2020 arrihet në disa përfundime që kanë ndikuar në grumbullimin e të ardhurave nga Bashkia, ndër të cilat vecojmë:

- ✚ Mungesë e mbështetjeve ligjore për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave.
- ✚ Mungesë e infrastrukturës se përshtatshme për vjeljen, grumbullim dhe magazinimin e produkteve.
- ✚ Mungesë e teknologjisë së vjeljes, përpunimit dhe ruajtjes së prodhimeve dhe produkteve pyjore dhe kullosore brenda territorit apo në afërsi të Bashkisë.
- ✚ Kushtet kritike të relievit që lidhen me shpërndarjen e këtyre produkteve në natyrë.
- ✚ Mungesë e tregut të garantuar, marketingut dhe të promovimit të produkteve dhe prodhimeve me origjinë pyjore dhe kullosore.
- ✚ Grumbullimi dhe manipulimi i prodhimeve me origjinë pyjore e jo pyjore nga individ apo dhe subjekte pa eksperiencë dhe pa licensë, duke ju shmangur detyrimeve ligjore etj.

Probleme këto që gjatë planifikimit të burimeve financiare për vitin 2021, janë marrë në konsideratë me qëllim që disa nga këto faktor të mënjanoohen, dhe të tjerët të merren si pika të dobëta që nuk favorizojnë realizimin e të ardhurave nga pyjet dhe kullotat, por që merren në konsideratë.



E .Planifikimi i të ardhurave, Koha e realizimit të tyre.

Nisur nga potenciali dhe kapacitetet prodhuese që afrojnë pyjet dhe kullotat e **Bashkisë**, analiza e realizimit të të ardhurave të vitit 2020 (pavarsisht nga arkëtimet në arkën e Bashkisë), marrë në konsideratë kushtet dhe mangësitë e evidentura, qofshin ato që paraqiten si pengesa, ose ato që kanë ndihmuar në realizimin e buxhetit finaciar, në planifikimin për vitin 2021 janë marrë në konsideratë:

Si përfundim për vitin 2021 planifikohet të realizohet një vjelje të ardhurash në masën prej 2.000.000 lekë:

Këto të ardhura planifikohen të realizohen nepërmjet ushtrimit të aktiviteteve

- Nga Prodhimet e dyta pyjore e bimët MET.
- Nga tarifat në dhënie në përdorim fond pyjor/antena të telefonisë celulare dhe jo vetëm.

Spektori i Pyjeve do të bëjë përpjekjet maksimale në mënyrë që të rritë performacën për rritjen e të ardhurave nga administrimi i qëndrueshëm i fondit pyjor kullor. Kjo nuk mund të realizohet pa bashkëpunimin e Administratorëve të NJ.A të zonave pyjore .

Bazuar në dispozitat ligjore është miratuar me VKB nr 4 dt 30.01.2018 LISTA e KULLOTAVE të gatëshme për kullotje për sezonin e verës, për të cilën do të kërkohet që të realizohen kontrata për kullotje të bagëtive dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të tyre. Tabela në Aneks.

Promovimi në vazhdimësi i resurseve pyjore të Bashkisë Shkodër ka bërë që të rritet interesimi për përdorimin e këtyre sipërfaqeve në funksion të zhvillimit ekonomik në përgjithësi dhe atij të zonës në vecanti. Aneks.

Tabela më poshtë jep kërkesat e subjekteve fizikë/juridikë për marrjen në përdorim të këtij fondi pyjor.

Nisur nga fakti që procedura ligjore është relativisht e gjatë për realizimin e këtyre kërkesave, bëjmë me dije se këto “ përdorime” nuk janë parashikuar në të ardhurat që planifikojmë të realizojmë gjatë vitit 2021, por përpjekjet e të gjithë stafit do të jenë për një realizim në një kohë sa më të shkurtër.



F. Mekanizimi i vjeljes i të ardhurave gjatë vitit 2021

E cilësuam më herët se burimet financiare dhe mjetet e tjera të jetesës, komuniteti i zonave i ka të lidhura me shfrytëzimin e resurseve natyrore që ofrojnë pyjet dhe kullotat e Bashkisë. Këto burime të ardhurash për komunitetin dhe Bashkinë mbështeten në drejtimet e cilësuara më sipër. Prandaj për realizimin e të ardhurave të planifikuara, Bashkia do të ndjekë rrugët e më poshtme:

- ✚ Njëpërmjet aktivizimit të Shoqatave të Përdorueseve të Pyjeve dhe kullotave .
- ✚ Njëpërmjet aktivizimit të përdorueseve të pyjeve dhe kullotave.
- ✚ Njëpërmjet shfrytëzimit të të drejtave që përcaktohen ne,VKM nr.391 date 21,06,2006 i ndryshuar.VKM nr.632 date 11,6,2009 ;VKM nr. 1064,date 22.12.2010.Vendime këto që përcaktojnë edhe tarifat e shfrytëzimit të pyjeve dhe kullotave.
- ✚ Njëpërmjet mbledhjes së tarifave dhe taksave për prodhimet pyjore e kullosore të përcaktuara me ligj.
- ✚ Njëpërmjet vjeljes së tarifës për furnizimin me dru zjarri të banorëve sipas Nj.A.
- ✚ Njëpërmjet vjeljes së tarifave për tokat pyjore dhe kullosore që planifikohen të jepen në përdorim sipas ligjeve ne fuqi.
- ✚ Njëpërmjet vjeljes së tarifave për shfrytëzimin e kullotave në pyje dhe në ato me shtresë barishtore.
- ✚ Njëpërmjet vjeljes tarifave të prodhimeve të dyta pyjore, Bimet MET, të cilat do të aplikohen mënyra e dhenies me ankand subjekteve.

G.Investimet në pyje dhe kullota.

- Investimet që parashikohen për vitin 2021

Nisur nga nevojat e pyjeve dhe kullotave për shtimin dhe përmirësimin e tyre në funksion të komunitetit, Bashkia parashikon që për vitin 2021 të siguroje investime/ shpenzime gjithësejt **5.339.000** leke. Këto investime do ta kenë burimin e financimit nga buxheti i vetë Bashkisë.

- Drejtimi i investimeve do te jetë:

- ✚ Shëndetsimi i Plantacioneve të Gështenjave.
- ✚ Përmirësime Pyjore,Krasitje pishash
- ✚ Hartimi i planeve të menaxhimit për ekonomin pyjore
- ✚ Mbrojtja e Pyjeve nga zjarri



H. Planifikimi punimeve dhe prerjeve te lejuara

- Planifikimi i Objekteve te punimeve .

Planifikimi i punimeve me investime sipas objekteve, janë bërë në përputhje me urgjencat e parashikuara ne Planet e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, ku janë hartuar edhe projekt preventivat përkatëse.

Keto punime jane parashikuar të kryhen nga burimi i të ardhurave te Bashkise, si dhe nga mundesimi i gjetjes se fondeve nga donatorë te tjere me konkurim.

-Parshikimi kohës së kryerjes të investimit.

Duke gjykuar në natyrën e përzgjedhjeve të investimeve që parashikohet të realizohen koha e realizimit te tyre do të jetë viti pyjor dhe për raste të tjera viti buxhetor.

K. Risqet:

Natyrisht që në këtë proces planifikimi kemi parashikuar edhe riskun, i cili qëndron në vështirsitë që krijohen gjatë grumbullimit të të ardhurave nga tarifatat dhe taksat prej përdorueseve.

Nga pamundësia (natyrisht realative) e mbështetjes se donatorëve dhe projekteve në sasi të që janë planifikuar.

Kushte klimaterike e mjedisore etj.

Pra sikurse shihet risqet, ne i kemi të natyrës njëzore dhe jo natyrës mjedisore ekologjike.



ANEKS.

- 1. Tabela me kërkuesit për dhënie në përdorim fond pyjor.**
- 2. Tabela /Lista me sipërfaqet kullosore të miratuara për dhënie në përdorim.**
- 3. Tabelat 3/4/5 , parashikimi i vjeljes dhe grumbullimit të bimëve mjeksore, eterovajore dhe tanifere (BMET).**
- 4. Tabela 6. Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021**



Tabl.

Kërkuesit	Ek. Pyjore/kullosore	Ngastra	Perdorimi I territorit	sipërfaqia
Nosh Lejthija /Agropylltari	Shosh 2	Sip djerr	djerr	2 ha
Edmond Lula	Prueмос-sheldi	54c dhe 59	Pyll/ lloji shkurre	25 ha
Marjana Fushazi	Shosh 2	70a	pyll	0.3 ha
Dorina Pali	Prueмос -Sheldi	87a	pyll	5 ha



Tab.2

PASQYRA E E SIPERFAQES DHE KAPACITETIT KULLOSOR SIPAS EKONOMIVE KULLOSORE															
KULLOTAT BASHKIAKE															
Nr.	Ekonomia Kullimore	Kodi kadastral	Nr. i pronesise	Nr.ngastra/n enegastra	Siperfaqia ne ha			Aftesia nbajtese ne krere							Tipi i kullotes
					Gjithsej/ha	E dobishme	E pa dobishme	Nr.i krereve Gjithsej	Dhi	Tarifa/njesi	Vlera leke	Nga Keto		Vlera leke	
											Dele	Tarifa/njesi	Vlera leke		
1	Maja e pejes -Qafa e Peje	SH02 0 001	447	1	75.00	56.7	18.3	427	0	0	0	427	100	42700	Verore
2	Maja e pejes-Shpina	SH02 0 002	448	2	33.60	21	12.6	157	0	0	0	157	100	15700	Verore
3	Maja e pejes-Fusha Runic	SH02 0 003	449	3	58.30	32.2	26.1	241	0	0	0	241	100	24100	Verore
4	Maja e pejes-Vukaçe	SH02 0 004	450	4	67.50	34.6	32.9	259	0	0	0	259	100	25900	Verore
5	Maja e pejes-Bridishja	SH02 0 005	451	5	43.00	32.8	10.2	245	0	0	0	245	100	24500	Verore
6	Maja e pejes-Fusha e Liqe	SH02 0 006	452	6	138.90	119.4	19.5	893	0	0	0	893	100	89300	Verore
7	Maja e pejes-Jezerca	SH02 0 007	453	7	166.20	90	76.2	673	0	0	0	673	100	67300	Verore
8	Maja e pejes-Majsore	SH02 0 008	454	8	99.10	50.8	48.3	380	0	0	0	380	100	38000	Verore
9	Maja e pejes-Peça Keqi	SH02 0 009	455	9	76.00	46.6	29.4	349	0	0	0	349	100	34900	Verore
10	Maja e pejes-Gropa e Bu	SH02 0 010	456	10	82.80	49.4	33.4	370	0	0	0	370	100	37000	Verore
Totali Ek.Kull,Maja Pejes					840.4	533.5	306.9	3994	0			3994		399400	
1	Shale -Leburi(Gimaj)	SH05 0 002	457	2	15.6	13.6	2	279	150	80	12000	129	100	12900	Verore
2	Shale -Biga(Gimaj)	SH05 0 003	458	3	37.4	35.2	2.2	287	0	80	0	287	100	28700	Verore
3	Shale -Lugu Gurren(Gimaj)	SH05 0 004	459	4	39.4	38	1.4	300	100	80	8000	200	100	20000	Verore
4	Shale -Buni Jakut(Gimaj)	SH05 0 005	460	5	51.5	48.6	2.9	183	0	80	0	183	100	18300	Verore
5	Shale -Maja Zeze(Lekaj)	SH05 0 006	461	6	82	79.2	2.8	444	120	80	9600	324	100	32400	Verore
6	Shale -Bjeshka Madhe	SH05 0 007	462	7	85.5	82.6	2.9	764	250	80	20000	514	100	51400	Verore
TOTALI EK,Kull,Shale					311.4	297.2	14.2	2257	620		49600	1637		563100	
1	RosRrjoll-Kalaja e Drishtit	SH04 0 002	1992	2	25.2	21	4.2	49	0	80	0	49	100	4900	Verore
2	RosRrjoll-Rrenimi(Rosek)	SH04 0 003	1993	3	88.7	73	15.7	66	0	80	0	66	100	6600	Verore
3	RosRrjoll-Shpella Korbit	SH04 0 004	1994	4	86.3	47.4	38.9	54	0	80	0	54	100	5400	Verore
4	RosRrjoll-Suka e dhive	SH04 0 005	1995	5	42	27	15	44	0	80	0	44	100	4400	Verore
5	RosRrjoll-Qebajet	SH04 0 006	1996	6	24.5	17.7	6.8	83	0	80	0	83	100	8300	Verore
6	RosRrjoll-Koder Hisna	SH04 0 007	1997	7	28.7	27.2	1.5	68	0	80	0	68	100	6800	Verore
7	RosRrjoll-Maja mbi Flete	SH04 0 008	1998	8	92.4	90	2.4	370	0	80	0	370	100	37000	Verore
Totali Ek.Kull.Rosek Rrjoll					387.8	303.3	84.5	734	0	80	0	734	100	73400	
Totali i Ekonomive Kullimore					1539.6	1134	405.6	6985	620		49600	6365		1035900	
VKM, Nr.632,date11,06,2009 "Per Miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje"															

Tab 3

TABELA PERMBLEDHESE E BOCEVE TE PISHES															
Nr.	Ekonomia pyjore	Objekti	Nr Prones	Ngastra nr	Siperfaqe Ha	Lloji	Klasa e Moshes	Tr.d	K.d	Nr.Drure Per Ha	Nr.Drurane frutifikim Per Ha	Sasia e boceve te pishes			
												Per 1 dru kg	Per 1 Hane kg	Per ngaster kg	Per ngaster kv
1	Prruemos Sheldi	Lodertun	1973	23a	24.5	P. detit+Bute	II	0.5	0.8	1480	355	1	355	8697	87
2	Prruemos Sheldi	Kodra Giçarit	1975	24a	40.8	P. detit+Bute	II	0.6	0.8	1200	320	0.9	288	11750	118
Shuma					65.3										205

Tab 4

Te dhena per Shqopen																			
Nr.	Ek.Pyjore	Ngastra nr.	Nr.prones	OBJEKTI	Perberja e Llojeve	Sip ne Ha	Sip nderhyrjes ha	Mosha vjet	Lartesia m	Dm cm	Kurora dendesia	Nr.drurave /ha	Nr.drurave per ngaster	Volum m3	Nderhyrja ne %	Nr i drurave per nxjerrje rrenesh	Sasia e perdoreshme e rrenjeve /dru kg	Sasia totale kg	Sasia Ne kv
1	R.Drisht	201	1941	Bokat e Bardha	5Ma+4Shk+1 Shq	45.3	5	25	4	4	0.3	500	2500	100	30	750	3	2250	22.5
2	R.Drisht	202b	1942	Faqia e Frashnit	5 Shk+1Ma+4Shq	15	5	40	3	5	0.3	700	3500	136	30	1050	4	4200	42
3	R.Drisht	202c	1943	Faqia e Frashnit	3 Shk+5Ma+2Shq	19.95	3	30	4	5	0.3	800	2400	100	30	720	3.2	2304	23.04
4	R.Drisht	205b	1945	Faqia e serres Madhe	6Ma+2Shq+2 tjera	31.25	6	50	4	7	0.3	1500	9000	180	30	2700	4.5	12150	121.5
Totali						111.5													209.04

Tab5

Tabela e BIMEVE M.E.T						
Nr	Ekonomija pyjore	Ngast. Nr	Lloji i bimeve M.T.E	Pjesa e bimes qe grumbullo het	Sasia Kv	Vlera Totale Leke
1	ROSEK-RRJOLL	12-Jan	Sherbele	Gjethe	50	7500
2	PRUMOS -SHELDI	6-14 ;52/a,b,c;;92a, 93a,94a,101b,102a; 104,105 b,c.	Sherbele	Gjethe	50	7500
3	ROSEK-DRISHT	43 a,b,c,44,52a,b,c,54a, 55a,63a,c;;64b,c;65 b,67b,c;68b,69b,70a, b,71a,b,72a,b,c;81b; 82a;83a;84a,c,d;94a ;95, ,112a,b;122a,c;123a ;132b deri135a;	Trumze	Herbe	100	7000
4	Lugina e Kirit	Ngastrat;34; 122b;123 a,b;125;126;135a;13 9b;140;157a,b;158;1 87 .	Trumze	Herbe	50	3500
5	Lugina e Shales	Ngastra kullosore, 2- 7;Shale-1 ngstrat: 2b;4a,b;37b,38b;44b ,47a,b;48a,b,c;86;	Trumze	Herbe	50	3500
6	Shosh 1	Ngastra 45;46;47a,b;48;49;5 3b;69;71b;91a;113; 152;153;	Trumze	Herbe	50	3500
Shuma						32500

Tab 6.

PLANIFIKIMI I TE ARDHURAVE NGA PYJET DHE KULLOTAT PER VITIN 2021									
Baza Ligjore									
Planifikimi i te ardhurave, i Bazuar ne VKM nr. 391 date 21.06.2006 "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave" VKM nr.1064 date 22.12.2010 " per disa ndryshime ne VKM nr. 391 date 21.06.2006 "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave". VKM, Nr.632,date 11,06,2009 "Per Miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje"									
Nr	Emertimi i aktiviteteteve	Njesia	Sasia	Cmimi njesi leke	Mbeshtetja ligjore VKM				Vlera leke
					Nr	Date	Lidhj	pika	
1	Bime medicionale,Nga Keto:		350						32500
1.1	Herbe	Kv	250	70	391	21.6.2006	5	16	17500
1.2	Gjethe	Kv	100	150	391	21.6.2006	5	14	15000
2	Prodhime te dyta pyjore,Nga Keto								115900
2.1	Mbeturina pylli te çdo lloji	m ³	1350	40	391	21.06.2006	5	2	54000
2.2	Boçe pishash	Kv	205	200	391	21.6.2006	5	20	41000
2.3	Kucka ,rrenje(shqope)	Kv	209	100	391	21.06.2006	5	4	20900
3	Nga kullotat Bashkiake,Nga Keto:								741100
3.1	Nga kullota Verore(kullotje natyre)	Krere	620	80	632	11.06.2009	a	2	49600
3.2	Nga kullota Verore(kullotje natyre)	Krere	50	800	632	11.06.2009	a	3	40000
3.3	Nga kullota Verore(kullotje natyre)	Krere	6315	100	632	11.06.2009	a	1	631500
3.4	Nga kullotje ne natyre te pyjeve	Krere	200	100	632	11.06.2009	a	2	20000
4	Aktivite Tjera./ PERDORIM ME QERA								1400000
Totali i te ardhurave									2289500